

VENDIM
Nr.820, datë 6.12.2006

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË I TRASFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
KOMUNËS CUKALAT, QË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, komunës Cukalat të qarkut të Beratit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Cukalat të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.2, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Cukalat”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Cukalat për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Cukalat

Lidhja nr.1

Numrat rendor të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
6-8	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
9-23	Infrastrukturë (troje e lirë)	Në përdorim
41;42	Administratë	Në pronësi
24-40	Shërbim funeral	Në pronësi
43	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
71-484	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
52;59,62,66;69;70	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
50;51;53;54;55;56;57;58;. 60;61;63;64;65'67;68	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim